

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ Huna Oil ” sh.p.k.

Në Durrës, sot më datë 31.10.2024 (dymijë e njëzet e kater), personi fizik:

Z. Orest Huna, atësia Sajmir, amësia Etleva, i lindur më 03.09.2004, në Durrës dhe banues në Durrës, me adrese Lagja Nr. 17, Rruga “Danubi”, shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me Nr. 038381963 dhe Nr. personal K40903066I, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Vendosi sa vijon:

NENI 1

Themelohet shoqëria tregtare : “ **Huna Oil** ” Sh.p.k

Ortaku themelues i saj është:

a) Z. Orest Huna 100%.

Shoqëria tregtare “ **Huna Oil** ” Sh.p.k, do të jetë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

NENI 2

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Durrës, Vrrinë, Shenavlash, Pasuria me Nr. 237/23, ZK 3339.

NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Me vendim të ortakut, mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si degë apo përfaqësi edhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali i shoqërisë

1. Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 000 lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është 100 % i kapitaleve të shoqërisë. :
2. Ortaku themelues **Orest Huna** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë kapitalin themeltar; Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë;

Po kështu transferimi i Kuotave bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve.

Ortaku ka të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me një afat të pacaktuar.

NENI 6

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në përputhje me ligjin dhe statutin.

NENI 8

Shoqëria “ **Huna Oil**” sh.p.k. krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë: Shitja me pakice e karburanteve (nafte, benzine, gaz).

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart në veprimtarinë sipërmarrëse të shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari tjetër industriale, tregtare, financiare dhe që do të konsiderohet nga ortaku e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk ndalohej nga ligji.

NENI 9

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.

NENI 10

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 11

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi me i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i njuh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë.

NENI 12

Administratori i Shoqërisë do të jetë:

Z. Orest Huna, atësia Sajmir, amësia Etleva, i lindur më 03.09.2004, në Durres dhe banues në Durres, me adrese Lagja Nr. 17, Rruga "Danubi", shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me Nr. 038381963 dhe Nr. personal K40903066I, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i shoqërisë, **Z. Orest Huna**, emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

NENI 13

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje origjinale, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky akt u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesi i cili deklaroi se akti është i rregullt tërësisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të tij, jep pëlqimin për sa përmendet në akt dhe nënshkruan rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISË TREGTARE

“ Huna Oil ” sh.p.k.

Orest Huna